



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**



**Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit**  
**Telecommunications Regulatory Authority**  
**Regulativni Autoritet Telekomunikacije**

Nr. Prot. 116/1/10

**Draft Rregullore**

**Për**

**Sigurimin e Qasjes**

Kjo Rregullore është nxjerrë në bazë të Nenit 1 pika 2, Neneve 53, 56, 57, të Ligjit për Telekomunikacion 2002/7, të ndryshuar me ligjin Nr. 03/L-085 (tutje i njohur si - Ligji), pika (3.8.4) i dokumentit të Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit të datës 13.06.2007, Planit të Veprimit për Partneritetit Evropian, duke marrë parasysh Direktivën 2002/19/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian të datës 7 Mars 2002 mbi qasjen në, dhe ndërlidhjen e, rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe pajisjeve shoqëruese (Direktiva e Qasjes).

**Neni 1**

**Fushëveprimi dhe Qëllimi i kësaj Rregulloreje**

- 1.1. Rregullorja për sigurimin e qasjes (tutje e njohur si Rregullorja) përcakton kushtet për publikimin e Ofertës Referuese për të siguruar qasje dhe të shërbimeve të lidhura (tutje e njohur si Ofertë Referente), kërkesat mbi përmbajtjen e Ofertës Referuese, procedurën dhe kushtet për sigurimin e qasjes dhe shërbimeve përcjellëse të specifikuar në Ofertën Referuese si dhe informatat.
- 1.2. Qëllimi i Rregullores është që të siguroj që ndërmarrjet nuk do të diskriminohen

dhe do të kenë mundësi të barabarta sipas kushteve të drejta, objektive dhe transparente për të fituar qasje.

- 1.3. Kjo Rregullore do të zbatohet ndaj ndërmarrjeve, të cilat sipas procedurës së themeluar nga aktet ligjore konsiderohen ndërmarrje me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës dhe të cilat ekzekutojnë detyrimet sipas nenit 57 të Ligjit.
- 1.4. Të gjitha dokumentet, të kërkuara nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (tutje e referuar si ART) do të dorëzohen sipas procedurës, se përshkruar me këtë Rregullore si dhe do të jenë në përputhje me kërkesat, procedurat dhe kushtet e përcaktuara me Rregulloren për dorëzimin e dokumenteve në ART.

## **Neni 2 Definicionet**

Për qëllim të kësaj rregulloreje:

- 2.1. Kuptimi ose definicioni cilëso fjalë, frazë apo shprehje në bazë të ligjit për telekomunikacion do të jetë gjithashtu i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë rregullore.
- 2.2. Termat dhe shprehjet që pasojnë do të kenë këtë kuptim:

**Vendi i përdorimit të përbashkët;** do të thotë shërbim në sigurimin e lokacionit dhe kushteve teknike, me kusht të strehimit të përshtatshëm të pajisjeve të përfituesit dhe lidhjen e pajisjeve në pajisjet korresponduese të operatorit sipas kërkesave, të parashikuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje .

**Vend i përbashkët fizik;** do të thotë, një vend për përdorim të përbashkët, ekzistues në lokalet në të cilin elementi i rrjetit për të cilat qasja është dhënë, është i instaluar.

**Përfitues;** do të thotë një ndërmarrje që ka aplikuar me shkrim në lidhje me ofrimin e informatave të përmendura në paragrafin 8.4 dhe/ose 8.7 të kësaj rregulloreje dhe/ose të qasjes dhe/ose një vend të përdorimit të përbashkët.

**Vend i largët për përdorim të përbashkët;** do të thotë, një vend i përdorimit të përbashkët i cili nuk gjendet në ambientet ku janë instaluar elementet e rrjetit, për të cilat është dhënë qasja.

**Operatori;** do të thotë një ndërmarrje e siguruar ose autorizuar për të siguruar një rrjet publik të telekomunikacionit apo një strukturë të lidhur.

**Lokacioni Virtual për përdorim të përbashkët;** do të thotë një vend i përdorimit të përbashkët, në të cilën pajisjet përkatëse të Përfituesit janë instaluar në kuadrin e shpërndarjes së njëjtë pranë një elementi të rrjetit, për të cilat qasja është dhënë, e operuar nga Operatori.

**Kablo e lidhur;** do të thotë kablo që përdoret për lidhjen e pajisjeve të Operatorit me pajisje të Përfituesit.

**Kablo Jashtme lidhëse;** do të thotë kablo lidhëse që përdoret për lidhjen e pikës hyrëse përkatëse të përbashkët të Operatorit me pajisje të Përfituesit, në rastet e një vendi të largët për përdorim të përbashkët.

**Ndërmarrësi;** një person fizik ose juridik apo një grup i personave të lidhur nga virtyti i kontrollit apo varësisë që është e angazhuar në aktivitete të telekomunikimit në Republikën e Kosovës.

**Oferta Referuese;** kushtet e bëra publike nga një operator, sipas të cilës ai bën një zotim për të ofruar qasje në çdo ndërmarrësi e cila kërkon një qasje të tillë.

### Neni 3

#### Kushtet për publikimin e Ofertës Referuese

- 3.1. Operatori duhet, jo më vonë se brenda periudhës kohore prej 2 muajsh nga data e vendimit të Bordit të ART-së, me të cilin vendim Operatori konstatohet të jetë një ndërmarrje me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës dhe për të cilën (me përjashtim të detyrimeve të tjera) detyrimi i transparencës është vendosur:
  - 3.1.1. Të paraqes për aprovim, në ART, draft ofertën referente, në përputhje me kërkesat të parapara në Nenin 4 të kësaj rregulloreje.
  - 3.1.2. Brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së draft ofertës referente, ART do të shqyrtojë dhe aprovoj ofertën referente ose do të kërkojë nga Operatori të

bëjë ndryshimet duke zbatuar “*mutatis mutandis*” procedurë e paraparë në paragrafin 3.2 të këtij neni.

- 3.1.3. Të publikoj ofertën referente, të aprovuar, në faqen e saj të internetit. Në rast se operatori nuk ka një faqe në internet, Operatori do të sigurojë që oferta referente është publike dhe ne te mund te ketë qasje çdo person pa pasur nevojë te paguaje ndonjë shumë për këtë.
- 3.2. ART do të ketë të drejtë t’i kërkojë Operatorit, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga ART, për të ndryshuar kushtet e ofertës referente, duke përfshirë edhe çmimet, në rast se kushtet nuk janë në përputhje me kërkesat të përcaktuara me ligj, këtë rregullore dhe aktet të tjera ligjore.
- 3.3. Operatori duhet vazhdimisht të azhurnojë ofertën referente, në rast të ndonjë ndryshimi teknologjik dhe/ose ndryshimi të tregut.
- 3.4. Operatori duhet të informoj ART-ne mbi çdo ndryshim të ofertës referente, të planifikuar me iniciativë të Operatorit, dhe të paraqesë ofertën referente të ndryshuar në ART, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregullore, si edhe tabelën e ndryshimeve të planifikuara, duke specifikuar paragrafët e ndryshuar dhe/ose plotësuar dhe/ose anuluar të ofertës referente.
- 3.5. Me hyrjen në fuqi të ofertës referente te azhurnuar, me kërkesën e ndërmarrjes së cilës tani më i është dhënë qasja, Operatori do të, azhurnoje kushtet për dhënien e qasjes në përputhje me ofertën valide referente.

#### **Neni 4**

#### **Kërkesat mbi përmbajtjen e Ofertës Referente**

- 4.1. Operatori do të japë dhe specifikoj në ofertën referente si vijon:
  - 4.1.1. Në konsiderim të detyrimeve të përcaktuara:
    - a) Informata në lidhje me qasjen në elementet specifike të rrjetit dhe (ose) pajisjeve.
    - b) Informata në lidhje me qasjen në vendet fizike, qasjen në lokalet dhe infrastrukturën e telekomunikuese.

- c) Kushtet teknike në lidhje me qasjen, duke përfshirë karakteristikat teknike të qasjes.
- 4.2. Shërbime të tjera përcjellëse që janë të nevojshme për të siguruar ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike për përdoruesit nëpërmjet qasjes, që i sigurohen Përfituesit;
- 4.3. Kushtet për përdorimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike të Operatorit (kabllot, kanalet, kullat, shtylla, etj), në lidhje me sigurimin e qasjes;
- 4.4. Shërbimet, që lidhen me sigurimin e një lokacioni për përdorim të përbashkët, duke përfshirë:
- 4.4.1. Kushtet për sigurimin e përdorimit të përbashkët të lokacionit fizik, virtual dhe në distancë të largëta;
- 4.4.2. Kërkesat për sigurinë e vendeve të përdorimit të përbashkët, të përcaktuara nga Operatori si dhe mjetet për sigurimin (implementimin) e këtyre kërkesave;
- 4.4.3. Kushtet, sipas të cilit Përfituesi do të ketë mundësi të vizitoj vendet, në të cilat i ka të vendosura pajisjet;
- 4.4.4. Parametrat teknike, karakteristikat dhe kufizimet, nëse të tilla ekzistojnë për pajisjet të cilat mund të instalohen në vendin e përdorimit të përbashkët;
- 4.4.5. Kushtet e hyrjes së punonjësve të Përfituesit, në një vend përkatës për përdorim të përbashkët;
- 4.4.6. Rregullat për shfrytëzimin e hapësirës, në një vend të përdorimit të përbashkët, në mes të përfituesve në rast se sipërfaqja e përdorimit të përbashkët është e kufizuar. Rregullat do të parashohin mundësinë që disa përfitues të përdorin një vend të përdorimit të përbashkët;
- 4.4.7. Kushtet, sipas të cilave përfituesit do të ketë mundësinë të vizitoj vendet e përdorimit të përbashkët, nëse një kërkesë e tillë është refuzuar;
- 4.5. Informata mbi qasjen në sistemet e mbështetëse operative;

- 4.6. Informata mbi ndërlidhjet teknike, protokollet dhe teknologjitë tjera të nevojshme për të siguruar kompatibilitet të shërbimeve, te siguruara nëpërmjet qasjes;
- 4.7. Kushtet, në rast të kërkesës së Përfituesit, nëse pika e qasjes me anë të radio frekuencave është e lidhur me rrjetin e operuar nga Përfituesi;
- 4.8. Kufizimet, nëse ato janë aplikuar për pajisje, të cilat disa operatorë mund t'i vendosin në të njëjtin vend;
- 4.9. Menaxhimin e të dhënave të trafikut, të Përfituesit;
- 4.10. Parametrat cilësisë së qasjes;
- 4.11. Masat të cilat sigurojnë integritetin dhe sigurinë e rrjetit të operatorit;
- 4.12. Standardet e nevojshme për dhënien e qasjes;
- 4.13. Kushtet dhe procedurat për sigurimin e çdo shërbimi, të përcaktuar në Paragrafët 4.1.1.- 4.7. të kësaj Rregulloreje, duke përfshirë:
  - a) Formën/Kërkesë standarde për ofrimin të secilit shërbim (më tutje Kërkesë);
  - b) Intervalin kohor për përgjigje në Kërkesë;
  - c) Intervalin kohor për ofrimin e shërbimeve dhe pajisjeve;
  - d) Intervalin maksimal kohor për eliminimin e defekteve;
  - e) Marrëveshjeve mbi nivelin e shërbimit, në rast se operatori ofron ndonjë, duke përfshirë edhe procedurën e zbatueshme në rast të rekomandimit të shërbimit të nivelit të zakonshëm;
  - f) Kushtet standarde të dispozitave të marrëveshjes për qasje, si dhe procedurën për dëmshpërblim, në rast se përgjigja në një kërkesë për të siguruar një shërbim të caktuar është i vonuar, formularin standard për ruajtje të konfidencialitetit, duke përfshirë dispozitat për sigurimin e riparimit të defektit;

- 4.14. Çmimet e secilit shërbim (duke përfshirë edhe tarifën fillestare të lidhjes, pagesat periodike dhe pagesat e tjera, në rast se çmimet janë ndryshuar fakti duhet të specifikohet) dhe/ose formulat e llogaritjes së çmimeve (algoritmet), afatet kohore dhe kushtet e pagesës;
- 4.15. Kërkesat specifike për përmbajtjen e ofertës referente sa i përket ofrimit të qasjes në lakun lokal, do të përcaktohen nga Operatori i cili është i detyruar të sigurojë qasje me qëllim të shthurjes së lakut lokal sipas Nenit 3 të Kushteve për Publikimin e Ofertës Referente (tutje Përshkrimi).

## **Neni 5**

### **Procedurat dhe Kushtet për Ofrimin e Shërbimeve dhe Informatave**

- 5.1. Operatori mund t'i refuzojë qasjen Përfituesit vetëm mbi bazën e kriterëve objektive, siç janë realizueshmëria teknike ose nevoja për të ruajtur integritetin e rrjetit. Barra e vërtetimit të pamundësisë për të ofruar një shërbim të caktuar, do të mbulohet nga Operatori.
- 5.2. Operatori nuk do të kufizojë mundësitë e Përfituesit për të ofruar shërbime ndërmarrjeve të tjera duke përdorur qasjen që i është dhënë.
- 5.3. Kur Operatori i refuzon Përfituesit për të ofruar shërbime, të specifikuar në një ofertë referuese, me motivimin se një refuzimi i tillë rrjedh nga mungesa e realizueshmërisë teknike, Operatori duhet t'i paraqesë një shpjegim të plotë Përfituesit mbi arsyet e refuzimit dhe të përcaktojë periudhën e saktë kohore, me skadimin e së cilës kërkesa do të jete zgjidhur dhe si e tillë do të jete e pranueshme. Në rastet kur operatori nuk pranon të japë shërbime të specifikuar në ofertën referuese Përfituesit, për shkak të kriterëve të tjera të përmendura në paragrafin 5.1 të kësaj rregulloreje, Operatori gjithashtu duhet të përcaktojë kushtet që duhet të plotësohen nga Përfituesi në mënyrë që operatorin të jetë në gjendje të plotësojë kërkesën. Në çdo rast, të përcaktuar në këtë paragraf, kur Operatori t'i paraqesë shpjegimet Përfituesit, duhet të paraqesë një kopje të shpjegimit të tillë në ART.
- 5.4. Në rast se ndonjë nga shërbimet, të specifikuar në ofertën referuese është e vonuar të sigurohet nga Operatori, jo për shkak të defektit, në emër të Përfituesit, Operatori do të informojë Përfituesin për këtë çështje menjëherë, duke paraqitur një shpjegim të plotë mbi arsyet e një vonese të tillë dhe do të specifikojë

periudhën e saktë të kohore, pas mbarimit të së cilës Operatori do t'i ofroj shërbimin e vonuar Përfituesit.

- 5.5. Kur ofrohen shërbimet e specifikuar në ofertën referuese, Operatori nuk do të zbatoj ndonjë kufizim për elementet e rrjetit që përdoren për ofrimin e shërbimeve, të cilat nuk kanë qenë të parapara në standardet e aplikueshme dhe karakteristikat teknike të dorëzuara nga operatori, duke përfshirë edhe kufizimet për ndërlydhje dhe lidhje të elementeve me rrjetet publike të komunikimit elektronik.
- 5.6. Operatori duhet, jo më vonë se brenda periudhës kohore prej 6 muajsh, nga data e publikimit të ofertës referente të krijojë mundësinë për Përfituesin për të paraqitur kërkesat dhe për të marrë informata, lidhur me Kërkesat, mbikëqyrjen e shërbimeve dhe eliminimin e defekteve të mjeteve elektronike.
- 5.7. Kushtet e ofertës referente nuk do të kufizojnë kohëzgjatjen e ofrimit të shërbimeve, të paraparë në ofertën referente. Ofrimi i një shërbimi, të përmendur në ofertën referente, mund të pezullohet ose të ndërpritet në mënyrë të njëanshme në rastet e mëposhtme:
  - a) Përfituesi refuzon shërbimet e ofruara;
  - b) Periudha kohore e funksionimit të elementit të rrjetit, për të cilat qasja i është dhënë Përfituesit dhe Operatorit informon Përfituesin mbi këtë çështje, siç përshkruhet në paragrafin 9.3 të kësaj rregulloreje;
  - c) Operatori i shkel kushtet thelbësore të marrëveshjes mbi sigurimin e qasjes;
- 5.8. Operatori dhe Përfituesi duhet që menjëherë të informojnë njëri-tjetrin dhe ART-në në rast të ndërprerjes së funksionimit të rrjeteve të ndërlydhura të komunikimit elektronik në rastet e forcës madhore dhe të situatave emergjente.

## **Neni 6**

### **Kushtet e veçanta për ofrimin e shërbimeve, të specifikuar në një Ofertë Referente**

- 5.1. Kushte të veçanta për ofrimin e shërbimeve, të specifikuar në një ofertë referente për të siguruar qasje në lakun lokal të shturur janë të përcaktuara në Rregulloren posaçme për LLU(Local Loop Unbundling).



## Neni 7

### Vendndodhja e Shërbimeve të Përbashkëta, dispozitat e përgjithshme dhe kushtet për Sigurimin e Shërbimeve dhe Pajisjeve Shoqëruese

Vendndodhja e Shërbimeve për përdorim të përbashkët dhe kushtet e përgjithshme për sigurimin e tyre;

- 7.1. Operatori do të sigurojë Përfituesin me mundësinë për të instaluar pajisjet, të nevojshme për ofrimin e shërbimeve, të përmendura në ofertën referente në një vend të përdorimit të përbashkët.
- 7.2. Operatori do të ofrojë të gjitha mënyrat për implementimin e një vendi të përdorimit të përbashkët, të specifikuar në paragrafët 7.5, 7.6 dhe 7.10 të kësaj rregulloreje, në çdo pikë brenda rrjetit, për të cilat qasja mund të sigurohet.
- 7.3. Operatori do të ofrojë një vend virtual të përdorimit të përbashkët, në rast se operatori nuk ka mundësi teknike për të caktuar lokacionin fizik të përdorimit të përbashkët, në lidhje me të cilën Përfituesi ka paraqitur një Kërkesë. Në rast të një vendi virtual për përdorim të përbashkët, instalimi dhe mbikëqyrja e të gjitha pajisjeve të Përfituesit do të ekzekutohet nga punonjësit e operatorit.
- 7.4. Operatori do të caktojë një vend të përdorimit të përbashkët në hapësirat e tij, në të cilin elementi i rrjetit, për të cilat është siguruar qasja është instaluar në përputhje me prioritet e mëposhtme:
  - 7.4.1. Pa instalimin ndarës ose strukturave tjera mbrojtëse.
  - 7.4.2. Përfituesi ose operatori, në emër të Përfituesit instalon një ndarje apo një tjetër strukturë mbrojtëse.
- 7.5. Operatori do të caktojë në hapësirat e veta, një vend të largët (remote) për përdorim të përbashkët në përputhje me prioritet e mëposhtme:
  - 7.5.1. Në një dhomë të veçantë, megjithatë në një dhomë, të ndryshme nga ajo për instalimin shpërndarjes kryesore ose të ndërmjetëm.
  - 7.5.2. Në dhomat të pa pajisura të Operatorit, instalimi kryhet nga operatori me shpenzimet të mbuluara nga Përfituesi ose nga Përfituesi me shpenzimet

e veta duke i pajisur apo bërë përshtatjen e dhomës. Kur operatori refuzon të ekzekutojë punët e sipërpërmendura, Operatori do të lejojë Përfituesin për të ekzekutuar punët.

- 7.6. Ku Përfituesi instalon vendin e përdorimit të përbashkët në hapësirat e veta, Operatori do të:
- 7.6.1. Ofrojë një kablo të jashtme lidhëse. Në rast se Përfituesi vendos për blerjen e shërbimit nga një operatori tjetër ose të bëjë vet shtrirjen e kabllos, Operatori do të informojë Përfituesin për mundësinë e përdorimit kanaleve kablore dhe pajisjet e tjera të shoqëruese.
  - 7.6.2. Të ofrojë një mundësi për të instaluar një sistem antene për lidhjen e pikës së qasjes me rrjetin, e operuar nga Përfituesi, përmes radio komunikimeve.
- 7.7. Në rast se vendndodhja e përdorimit të përbashkët në pikën e qasjes, e zgjedhur nga Përfituesi është instaluar sipas mënyrave, të përmendura në paragrafin 7.4.2. ose 7.5.2. të kësaj Rregulloreje, Operatori do të:
- 7.7.1. Jo më vonë se, brenda periudhës kohore prej 15 ditësh pune, nga data e pranimit të kërkesës, në rastet, të përmendura në paragrafët 7.4.2. dhe 7.5.2. të kësaj Rregulloreje, do të përgatisë dhe të paraqesë Përfituesit vlerësimin e shpenzimeve ,të punimeve të nevojshme për instalimin e një vendi të përdorimit të përbashkët.
  - 7.7.2. Jo më vonë se, brenda afatit të 36 ditëve të punës, në rastin e përmendur në paragrafin 7.2. të kësaj Rregulloreje ose jo më vonë se brenda afatit prej 60 ditëve të punës, në rastet e përmendura në paragrafin 7.5.2. të kësaj Rregulloreje, që nga momenti i miratimit të Përfituesit me vlerësimin e paraqitur nga Operatori, vendndodhjen e përdorimit të përbashkët duhet te jetë plotësisht e pajisur.
- 7.8. Në rast se një vend i përdorimit të përbashkët në një lokal të veçantë të përdorimit të përbashkët, të instaluar me shpenzimet e Përfituesit sipas mënyrave të përmendura në paragrafët 7.4.2 dhe 7.5.2. të kësaj rregulloreje i është dhënë një tjetër Përfituesi, Operatori do të përcaktojë rregullat për dëmshpërblimin e shpenzimeve te shkaktuara sa i përket pajisjeve në vendin e përdorimit të përbashkët të ish-Përfituesit, me qëllim të shpërndarjes

proporcionale të të gjitha shpenzimeve që lidhen me ekzekutimin e punëve të sipërpërmendura ndërmjet të gjithë Përfituesve ne bazë hapësirave të përdorimit të përbashkët që i kanë në shfrytëzim.

- 7.9. Një vend virtual i përdorimit të përbashkët në të gjitha rastet do të jetë në ambientet e Operatorit pa instalimin e ndarëseve ose strukturave të tjera mbrojtëse, në rast se asnjë marrëveshje tjetër nuk është arritur midis Operatorit dhe përfituesit në këtë drejtim.
- 7.10. Në të gjitha rastet, me përjashtim të atyre të përmendura në paragrafët 7.4.2 dhe 7.5.2 të kësaj rregulloreje, Operatori do të sigurojë një vend të përdorimit të përbashkët brenda periudhës kohore jo më të shkurtër se 15 ditë pune nga data e nënshkrimit të marrëveshjes për dhënien qasje.
- 7.11. Përfituesi mund të përdor lokacionin e siguar për përdorim të përbashkët për marrjen e llojeve të ndryshme të shërbimeve të qasjes. Vendi i caktuar për përdorim të përbashkët mund të përdoret për ndërlidhjen e rrjeteve të përfituesve.

## **Neni 8**

### **Procedura, Fushëveprimi dhe Kushtet për sigurimin e informatave**

- 8.1. Jo më vonë se brenda periudhës kohore 5 pesë ditë pune nga data e paraqitjes së kërkesës, Operatori dhe Përfituesi do të nënshkruajnë formularin standard të zotimit të konfidencialitetit, të përmendur në paragrafin 4.13.a) të kësaj rregulloreje, në rast se asnjë marrëveshje tjetër nuk është arritur midis Operatorit dhe Përfituesit në këtë drejtim.
- 8.2. Operatori, pas nënshkrimit të zotimit mbi konfidencialitetin, të përmendur në këtë paragraf të kësaj rregulloreje, në rast se asnjë marrëveshje tjetër nuk është arritur midis Operatorit dhe Përfituesit në këtë drejtim, pa asnjë kusht shtesë dhe kufizim do t'i sigurojë Përfituesit informatat e përmendura në paragrafet 8.3 dhe 8.6 të kësaj Rregulloreje, pa paragjykim të periudhave kohore të parapara në paragrafët 8.4 dhe 8.7 të kësaj rregulloreje.
- 8.3. Operatori kur i ofron Përfituesi informatat e përgjithshëm ne lidhje me rrjetin operues, duhet të paraqesë një listë të detajuar të të gjithë elementeve të rrjetit të tij, për të cilat qasja mund të sigurohet, duke specifikuar për çdo element të rrjetit si vijon:

- 8.3.1. Adresën duke specifikuar si vijon:
- Emri i lokalitetit të banuar;
  - Emri i rrugës;
  - Numrin e parcelës, ndërtesës ose kompleksit të ndërtesave në rrugë ose të lokalitetit të banuar;
  - Numri i banesës ose objekteve të pabanuara në ndërtesë;
  - Kodi postar, nëse është në dispozicion;
- 8.3.2. Topologji e rrjetit të operuar, për të cilat është siguruar qasja;
- 8.3.3. Territori, që shërbehet nga elementi i rrjetit;
- 8.3.4. Datat e skadimit, të afateve të funksionimit të elementeve të rrjetit dhe pjesëve përbërëse të saj;
- 8.3.5. Sipërfaqen e lokaleve në metra katror, në të cilën elementi i rrjetit për të cilat qasja është dhënë, si dhe përshkrimin teknik i objektit;
- 8.3.6. Mundësitë për të siguruar dhe / ose të instaluar fizikisht dhe / ose dhe / ose një vend të largët virtual për përdorim të përbashkët në lokalet e përmendura në pikën 8.3.5 të kësaj Rregulloreje në ambientet e caktuar ose në lokalet pranë.
- 8.4. Operatori do të paraqesë të gjitha informatat e përgjithshme, të përmendura në paragrafin 8.3 të kësaj rregulloreje, në një faqe të sigurtë interneti, qasja e së cilës do të realizohet nëpërmjet një kanali të koduar. Përfituesit menjëherë pas nënshkrimit formularit standard për zotimin mbi konfidencialitetin do t'i sigurohet qasja në këtë faqe të sigurt interneti, siç ceket në paragrafin 4.13. f) të kësaj rregulloreje, në rast se asnjë marrëveshje tjetër nuk është arritur midis Operatorit dhe Përfituesit në këtë drejtim.
- 8.5. Operatori duhet të sigurojë ofrimin e informatave të përgjithshme, të përcaktuara në paragrafin 8.4 të kësaj rregulloreje, nga data e publikimit të ofertës referuese. Operatori do të azhurnoj informatat në mënyrë që të siguroj që informatat pasqyrojnë kapacitetet ekzistuese të rrjetit dhe mundësi për të siguruar shërbimet, të specifikuar në ofertën referuese.
- 8.6. Operatori, që i ofron Përfituesit informata të detajuara mbi karakteristikat e veçanta të elementeve të rrjetit, për të cilat është siguruar qasja, duhet të specifikojë si në vijim:

- 8.6.1. Karakteristikat fizike dhe elektrike;
  - 8.6.2. Karakteristikat e Transmisionit;
  - 8.6.3. Parametrat teknik dhe të cilësisë, dhe në rast të ofrimit të qasjes në një lak të shthurur lokal, rezultatet e të tjera të matjeve të parametrave përkatës teknike dhe të cilësisë;
  - 8.6.4. Karakteristikat e sinjalizimit të përdorur;
  - 8.6.5. Të gjitha të metat e elementit të rrjetit, për të cilin Përfituesi kërkon për të siguruar qasje, dhe për të cilat operatori është në dijeni;
  - 8.6.6. Informata mbi kapacitetet e mundshme të lidhjes.
- 8.7. Operatori duhet t'i paraqesë Përfituesit informacionin e detajuar, të përmendur në paragrafin 8.6 të kësaj Rregulloreje dhe informacioneve të tjera, në lidhje me ofrimin e shërbimeve në ofertën referuese, jo më vonë se brenda periudhës kohore prej 10 ditë pune nga data e marrjes e kërkesës për të dhënë informacionin.
  - 8.8. Pas fillimit të negociatave në lidhje me ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në ofertën referuese, Operatori do t'i ofrojë Përfituesit të gjitha informatat, lidhur me shërbimet e jo më vonë se brenda afatit kohor prej 5 ditësh pune nga data e marrjes e kërkesës për të dhënë informacionin.
  - 8.9. Kërkesat e veçanta për informata, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në ofertën referuese për të siguruar qasje në një lak të shthurur lokal për ofrimin e shërbimeve të specifikuar, janë të parapara me nenin 8 të kësaj rregulloreje.

## Neni 9

### **Kushtet për mirëmbajtjen e Sigurimit dhe Eliminimin të defekteve të Shërbimeve, të specifikuar në Ofertë Referuese**

- 9.1. Operatori, me rastin e dhënies së shërbimeve të përcaktuara në ofertën referuese për Përfituesin do të eliminoj defektet dhe të kryejë mirëmbajtjen e elementeve të rrjetit për të cilat është dhënë qasja.
- 9.2. Operatori, me rastin e dhënies së shërbimeve të përcaktuara në ofertën referuese për Përfituesin, do të informojë paraprakisht Përfituesin për punët e planifikuara në mirëmbajtjen e rrjetit ose për punë të tjera në rrjetin e operatorit, që do të mund të kishin ndikim në cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Përfituesi në

mënyrë që Përfituesi të ketë mundësinë për t'u përgjigjur dhe të informojnë përdoruesit e tij.

- 9.3. Operatori do të informojë me shkrim Përfituesin, jo më vonë se 36 muaj para skadimit të periudhës përkatëse, sa i përket skadimit të afateve të operimit të çdo elementi të rrjetit, për të cilat qasja është dhënë si dhe për pjesët përbërëse të elementeve të rrjetit, të përmendura në paragrafin 8.3.4 të këtyre rregullave

### **Neni 10**

#### **Dispozitat përfundimtare**

- 10.1. Ndaj veprimit ose mosveprimit të ART-së në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje mund të bëhet ankesë në procedurën e përcaktuar nga ligjet që janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
- 10.2. Në rast se asnjë dispozitë tjetër nuk është e paraparë me ligjet e Republikës së Kosovës, atëherë trupi menaxhues i Operatorit do të jetë përgjegjës për dorëzimin në kohë të dokumenteve dhe të dhënave të Operatorit dhe informacioneve të tjera në ART, sipas kësaj Rregullore.
- 10.3. Operatori do të jetë përgjegjës për dështimin për të vëzhguar këtë Rregullore, sipas procedurës së, e përshkruar nga aktet ligjore të Republikës së Kosovës.

### **Neni 11**

#### **Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj me një vendim të Bordit të ART-së, dhe mbetet në fuqi deri sa të nxirret një rregullore tjetër.

**Klasa: 01/1**  
**Rreg. No.: 6**

**Prishtinë,**  
**28/12/2010**

**Ekrem Hoxha**  
**Kryetar i Bordit të ART-së**

---